



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Freelance Professions
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.20/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore në lëndët përmbardimore, P.nr.163/20,P.nr.464/20,P.nr.1101/20,P.nr.30/21,P.nr.44/21,P.nr.55/21,P.nr.241/21,P.nr.304/21, P.nr.361/21, P.nr.455/21, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, Petrit Reqica ,përfaqësues i palës ankuese-Divizionit Për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira dhe Përmbarduesi Privat, me datë 21.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-20/2022 i datës 19.05.2022, si dhe raporti-ankesa e palës ankuese Divizionit Për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira e datës 17.05.2022, **si të pabazuara.**

II. Përmbarduesi Privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në ,nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndët përmbardimore P.nr.163/20,P.nr.464/20,P.nr.1101/20,P.nr.30/21,P.nr.44/21,P.nr.55/21,P.nr.241/21,P.nr.304/21, P.nr.361/21, P.nr.455/21 .

Ar sy e t i m

Divizioni Për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira me datë 17.05.2022, ka parashtruar raportin e inspektimit të rregullt të kryer ndaj përmbauesit privat me kosntatimin dhe pretendimin se përmbauesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbaimore ,pasi nga raporti i inspektimit të rregullt që i është bërë përmbauesit, është konstatuar se përmbauesi privat ka bërë shkelje, duke tejkaluar shumën e shpenzimeve procedurale, duke inkasuar si shpenzim nga ana e debitorit shumën sa i përket propozimit për përmbaimit të përpiluar nga avokati i kreditorit, ku ka llogaritur dhe inkasuar shumën më lartë së sa 20 euro, ndërsa sipas udhëzimit për tarifën e përmbauesve privat, shuma që parashihet të inkasohet për përpilimin e propozimit, është shuma prej 20 euro. Me këtë rast përmbauesi ka dëmtuar palën debitorë, pasi ka inkasuar më tepër për këtë propozim të avokatit e me këtë ka tejkaluar tarifën në kundërshtim me udhëzimin për tarifën MD.nr.06/2014.

Gjithashtu përmbauesi ka përllogaritur si shpenzime administrative shumën e prezentuar nga kartela e kreditorit për debitorët, e që në rastet e inspektuara ka pasur obligim të parashkruar që është konstatuar nga gjykata dhe përmbauesi nuk ka bërë kthimin e diferencës së inkasuar në fillim si administrim, pasi kemi zbritje të obligimit për shumën e parashkruar.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbauesit privat.

Me datën 19.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimit Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë.

Përmbauesi Privat, në përgjigjen e tij ka deklaruar se tarifimi është bërë duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe të udhëzimit për tarifën.

Përmbauesi privat sikurse gjyqëtar, vendosin në shkallë të parë dhe palët mund të kenë avokat dhe përmbauesi duhet sikurse gjykata të ua njeh shpenzimet për avokatin si përfaqësues i tyre bazuar në tarifën e avokatëve. Vet komisioni i ministrisë ka venosur në këto raste sikurse edhe vet gjykata që tarifën e avokatëve duhet të njihen sipas tarifave të Odës së avokatëve.

Sa i përket tarifës së administrimit që e njëjta është llogaritur në fillim dhe pasi ka pasur zbritje të borgjit me vendim të gjykatës, askund nuk ceket se në këto raste duhet të kthehet një shumë e tillë, pasi nuk mund të paragjykojnë obligimet në ato raste dhe në analogji me gjykatat, asnjëherë taksat për inicim nuk kthehen, pavarësisht nëse kemi zbritje të kërkesave. Tarifa e administrimit është llogaritur në bazë të lartësisë së kërkesës së parashtruar nga kreditori dhe në atë shumë.

Përmbauesi e ka obligim që vetëm shumën e tarifës së efikasitetit t'a llogarisë në bazë të shumës së përmbaimit, e që në këto raste është vendosur kështoj, ndërsa në asnjë dispozitë tjetër nuk ceket që do duhej të kthehej shuma e administrimit aty ku kemi parashkrim dhe ulje të kërkesës. Përmbauesi më tutje ka theksuar se si përmbaues duhet që secilën herë të marrin parasysh mbrojtjen e debitorit, e që ajo mbrojtje duhet të vazhdojë gjatë tërë procedurës e jo vetëm në fillim.

Në seancën dëgjimore i autorizuari i palës ankuese ka deklaruar se LPP dhe UA për tarifrat, përcakton fillimisht se tarifrat fillestare arkëtohen nga kreditori dhe krejt në fund të procedurës, pasi të mbyllet procedura, përcaktohet se debitori e mbulon atë pjesë; se në situatën konkrete kanë pasur një prapësim nga ana e debitorit për shkak të të cilit edhe besojnë se Përmbartuesi Privat në momentin që e ka parë afatin e borxhit , ka qenë i vetëdijshëm se ajo pjesë e borxhit nëse do të prapësohet për parashkrim, do të prapësohej për shkak të kalimit të afateve për parashkrim. Poashtu ka theksuar se me përgatitjet e tij profesionale përmbartuesi privat ka qenë i vetëdijshëm që do të mund të parashkruhet ai borxh. Andaj , në këtë, përmbartuesi privat do duhej t'a kryente një detyrë, e cila pavarësisht se nuk është obligim ligjor deri në atë masë, t'a njoftojë kreditorin që borxhi i cili kërkohet , të përmbartohet, pasi i njejtë mund të parashkruhet në rast se bëhet prapësim. Në këtë rrethanë pavarësisht që nuk kemi pasur një rrethanë të tillë, në fund vendimi gjyqësor ka aprovuar pjesërisht prapësimin ku në të gjitha rastet e inspektuara në masën më të madhe, borxhi fillestar është parashkruar. Andaj, ka vlerësuar se në fund kur është bërë pasqyra e shpenzimeve përfundimtare për administrimin e tarifave ndaj debitorit është dashur që të merret parasysh neni 6, para 7 i UA ku është e përcaktuar qartë që për borxhin e lënë jashtë fuqisë me vendim të gjykatës.

,Përmbartuesit Privat nuk i takon shpërblimi, konkretisht në rastet konkrete të inspektuara, vërehet se arkëtimi i këtyre faturave, është bërë në emrin e shpenzimeve të Përmbartuesit Privat. Andaj, kanë vlerësuar që në rastet konkrete kemi të bëjmë me tejkalim të këtij Udhëzimi.

Përmbartuesi privat në seancën dëgjimore ka deklaruar se lidhur me pretendimet e palës ankuese, kjo çështje nuk ka të bëjë fare me taksën fillestare, ngase borxhi që mbetet dhe taksa fillestare janë dy gjëra krejt të ndryshme dhe përmbartuesi është i obliguar që pas vendimit të gjykatës për veprimet e mëtutjeshme të veprojë sipas atij vendimi. Poashtu ka theksuar se sa i përket çështjes së parashkrimit , parashkrimi është institut ku duhet të këtë kujdes edhe organi përmbartues dhe se Përmbartuesi privat nuk ka të drejtë as ta njoftoi debitorin e as kreditorin për parashkrim, pra është çështje e vet palës debitore se a dëshiron të thirret në parashkrim apo jo.

Komisioni vlerëson se propozimet janë përpiluar nga avokati i palës kreditore gjë që organi përmbartues ,këtu përmbartuesi privat duhet i'a nje shpenzimet për avokat bazuar në tarifrat e Odës së avokatëve dhe udhëzimi i tarifave për përmbartues nuk e rregullon tarifën e avokatit,por vetëm të veprimeve përmbartimore që ndërmerren nga përmbartuesi privat.

Pretendimi i palës ankuese se tarifa e administrimit do duhej të kthehej nga përmbartuesi tek rastet ku kemi parashkrim të pjesshëm të kërkesës kreditore,nuk qëndron ,pasi në momentin kur është bërë adminsitrimi,kërkesa kreditore ka qenë në atë shkallë për të cilën edhe është tarifuar dhe përmbartuesi ka administruar kërkesën për atë shumë të obligimit të debitorit,ndërsa tarifa e efikasitetit,për të cilën është obligim i përmbartuesit , duhet të llogaritet në shumën e përmbartuar ,bazuar në vendimin përfundimtar të gjykatës ku mundet të kemi zbritje të obligimit në bazë të parashkrimit të pjesshëm të obligimit dhe në këtë tarifë përmbartuesi duhet të inkasoj në shumë të përmbartuar , e jo në shumë të kërkuar nga kreditori si dhe të përmbahet tek të gjitha tarifimet tjera sipas udhëzimit.

Komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do provohej që përmbartuesi privat ka bërë tejkalim të tarifimit sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore tek rastet e cekura,pasi tarifimi për të cilin është inicuar ky rast disiplinor ka të bëjë me tarifim për avokatin lidhur me shpenzimet për përpilim të propozimeve për përmbartim, të cilat janë llogaritur pikërisht sipas Rregullores për Tarifa të Odës së Avokatëve të Kosovës e dt,18.03.2017,e cila është në fuqi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.20/2022 datë 21.07.2022



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.